

20131202861

L I G J
PËR HUAMARRJE TË M-NAV SHA-SHKUP TE BANKA EVROPIANE PËR
RINDERTIM DHE ZHVILLIM SIPAS MARREVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN
PËR MBINDERTIMIN E SISTEMIT MAQEDONAS PËR NAVIGACION TË
AVIACIONIT - FAZA E DYTE PA GARANCI SHTETERORE

Neni 1

M-NAV SHA-Shkup merr hua te Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim në shume prej 11 150 000 euro, të dedikuar për realizimin e Projektin për mbindertimin e sistemit maqedonas për navigacion të aviacionit - faza e dyte.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshjen për hua për Projektin për mbindertimin e sistemit maqedonas për navigacion të aviacionit - faza e dyte, që do të lidhet ndermjet M-NAV SHA-Shkup dhe Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim.

Në emer të M-NAV SHA-Shkup Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni, do ta nenshkruaje Keshilli Drejtues i M-NAV SHA-Shkup.

Neni 3

Afati i pageses së huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 12 vite, me grejs periodhe të perfshire prej tre vitesh.

Shkalla e kamates eshte e barabarte me EURIBOR të zmadhuar për 3,75 % në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet nente vite në çdo 15 mars, 15, qershor 15 shtator dhe 15 dhjetor. Pagesa fillon tre vite pas dites së nenshkrimin të Marreveshjen për hua nga neni 2 paragrafi 1 të ketij ligji.

M-NAV SHA-Shkup i paguan Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim provizion të njehershëm në lartesi prej 1,25% nga shuma e huas.

Për shumen e mjeteve të paterhequra të huas nga neni 1 i ketij ligji, Bankes Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim i paguhet provizion në nivel vjetor në lartesi prej 0,5% nga shuma e mjeteve të paterhequra të huas.

Për obligimet lidhur me huan nga neni 1 i ketij ligji që nuk do të paguhet në afatet e parapara, do të paguhet kamate ndeshkuese në lartesi të shkalles së kamates vjetore nga paragrafi 2 i ketij neni, të zmadhuar për 2% në nivel vjetor.

Neni 4

M-NAV SHA-Shkup huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga mjetet e veta.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".